



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

PRISHTINA



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PRISHTINES - OPSTINA PRISTINA  
DREJTORIA PER ARSIM DHE KULTURE-DIREKCIJA ZA PROSVETU I KULTURU

DREJTORIA E ARSIMIT

03 30 20.02.2024

Bazuar në dispozitat e nenit 62, paragrafi 62.3 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 57, pika c të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01 - 110 - 391, të dt. 25.02.2010, dhe në dispozitat e nenit 6, të Rregullores nr. 01-110-41917, dt. 29.03.2013 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Arsimit shpall:

## KONKURS

### PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I. Komuna e Prishtinës ndanë **120 bursa** për studentët që studiojnë në universitetet publike të Kosovës, për vitin akademik 2023/2024, në këto fusha të studimit:

<u>FAKULTETI</u>	<u>NUMRI I BURSAVE</u>
Fakulteti i Arteve .....	katër (4) bursa
Fakulteti i Shkencave Sportive.....	katër (4) bursa
Fakulteti Juridik.....	shtatë (7) bursa
Fakulteti Ekonomik .....	shtatë (7) bursa
Fakulteti Filologjik.....	tetë (8) bursa
Fakulteti i Edukimit.....	katërmëdhjetë (14) bursa
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti Filozofik.....	shtatë (7) bursa
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.....	shtatë (7) bursa
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës .....	dhjetë (10) bursa
Fakulteti i Mjekësisë.....	katërmëdhjetë (14) bursa
Fakulteti i shkencave matematiko-natyrore.....	katërmëdhjetë (14) bursa
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike ...	katërmëdhjetë (14) bursa

II. Vetëm studentët/et e rregullt, se paku 10 vjet banorë të komunës së Prishtinës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të universiteteve publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare - master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave komunale.

Faqe 1 nga 3

### III. Kriteret e përgjithshme:

1. Të kenë regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
2. Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar;
3. Të mos jenë përsëritës të vitit akademik;
4. Të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomiko-sociale të familjes.
5. Studentët që janë regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme.

### IV. Kriteret e veçanta:

1. nota mesatare mbi 9 (nëntë) vlerësohet me 30 pikë,
2. nota mesatare mbi 8 (tetë) vlerësohet me 20 pikë,
3. nota mesatare mbi 7 (shtatë) vlerësohet me 15 pikë,
4. studentët në asistencë sociale vlerësohen me 20 pikë,
5. studentët që studiojnë në lëndët deficitare vlerësohen me 15 pikë,
6. ai/ajo, që studion së bashku me një anëtar tjetër nga e njëjta familje vlerësohet me 10 pikë, (anëtari i familjes të jetë student/e i/e universiteteve publike),
7. ai/ajo, që nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohet me 10 pikë,
8. studentët me nevoja të veçanta vlerësohen me 10 pikë.

**Vëmendje:** Kriteret e veçanta sipas pikës gjashtë (6), vlerësohen vetëm për një student të asaj familje dhe vetëm nëse dëshmon me dokumentacion zyrtar se studentët tjerë të asaj familje i plotësojnë kriteret e përgjithshme.

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në piken IV, do të kenë përparësi studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, të gjinisë femërore dhe studentët që udhëtojnë nga fshati me larg se 15 km.

### V. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Kopja e ID-së së studentit;
3. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 2023/2024 (origjinale);
4. Certifikata e notave (origjinale);
5. Certifikata/Ekstrakti i lindjes;
6. Dëftesa për përfundimin e shkollës fillore në Komunën e Prishtinës (kopje).  
Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti do të konsiderohet se nuk e plotëson kriterin se është banor i Komunës së Prishtinës së paku dhjetë (10) vite;
7. Kopja e letërnjoftimit;
8. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk jeni në marrëdhënie pune.

*Për anëtarin e ngushtë të familjes së dëshmorëve edhe:*

Faqe 2 nga 3

9. Vendimi/Vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve;

*Për anëtarin e ngushtë të familjes në asistencë sociale edhe:*

10. Vendimi/Vërtetimi që dëshmon se aktualisht është shfrytëzues i ndihmës sociale (originale);

*Për studentët pa prindër edhe:*

11. Certifikata e vdekjes së prindit;

*Për studentët e regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2023/2024 edhe:*

12. Kopjet e vërtetuara të dëftësive dhe të diplomës për përfundimin e shkollës së mesme të lartë;

*Për studentët/anëtarë të ngushtë të së njëjtës familje edhe:*

13. Certifikatat/Ekstraktet e lindjes për të gjithë studentët/anëtarë të ngushtë të asaj familje;

*Për studentët me nevoja të veçanta:*

Vendimi/Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

## **VI. Afati dhe mënyra e aplikimit**

1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit prej dt. 21.02.2024 deri me datën 06.03.2024;
2. Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës;
3. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e Vjetër të Komunës së Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
4. Të gjitha aplikacionet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen;
5. Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrimet e dyanshme;
6. Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastit e shpalljes së rezultateve përkatëse.